

VENDIM
Nr.31, datë 20.1.2010

**PËR MIRATIMIN E LEJES PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E LINJËS
TREGTARE TË INTERKONJEKSIONIT, ME RRYMË TË VAZHDUAR,
KALLMET/LEZHË, (SHQIPËRI) - ZAPPONETA/MANFREDONIA, (ITALI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31 e 31/1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të linjës tregtare të interkonjeksionit me rrymë të vazhduar, Kallmet/Lezhë, (Shqipëri) – Zaponeta/Manfredonia, (Itali).

2. Miratimin e lejes nr.4/1, datë 7.12.2009 “Për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit me rrymë të vazhduar, Kallmet/Lezhë (Shqipëri)-Zaponeta/Manfredonia, (Itali), dhënë nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k.-së, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi nr.1515, datë 19.11.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e lejes për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, Kallmet/Lezhë, (Shqipëri) – Zaponeta/Manfredonia, (Itali)”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Në mbështetje të neneve 31 dhe 31/1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.529, datë 15.8.2007 “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit”, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.725, datë 7.11.2007 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.529, datë 15.8.2007 “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit”,

i jepet shoqërisë anonime “Biopower Green Energy” sh.p.k, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë, me nr. serial SN -004412-12-07, më datë 5.12.2007 dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me numër nipti: K72405024M, me seli në Tiranë, rruga “Sulejman Delvina”, Qendra e Biznesit Zayed.